



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E EKONOMISË DHE INOVACIONIT
AGJENCIA KOMBËTARE E PUNËSIMIT DHE AFTËSIVE
SHKOLLA PROFESIONALE ELBASAN

Nr. 519/5 prot.

Elbasan, më 22.09.2026

Lënda: Njoftim për vend të lirë

DREJTORISË JURIDIKE DHE BURIMEVE NJERËZORE
DREJTORISË SË MARRËDHËNIEVE ME PUBLIKUN
AGJENCIA KOMBËTARE E PUNËSIMIT DHE AFTËSIVE
TIRANË

Në zbatim të ligjit nr. 15/2017, "Për arsimin dhe formimin profesional në Republikën e Shqipërisë" neni 21, pika 2; të vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 756, datë 9.12.2021, "Për sistemin e njohjes së të nxënit të mëparshëm joformal dhe informal", Udhëzimit Nr. 1109, datë 16.12.2024 "Për procedurat e vlerësimit dhe të certifikimit për zbatimin e sistemit të validimit të të nxënit të mëparshëm joformal dhe informal", neni 14 pika 7,

Ofruesi publik i AFP-së, Shkolla Profesionale Elbasan, ju njofton krijimin e vendit të lirë për pozicionin:

- Këshillues (Specialist) - 1 (Një) vend vakant

1. Kriteret e përgjithshme kriteret e posaçme

Aplikanti duhet të plotësojë kriterete përgjithshme si vijon:

- a) të ketë zotësi të plotë për të vepruar;
- b) të jetë në kushte shëndetësore që e lejojnë të kryejë detyrën;
- c) të mos jetë i dënuar me vendim të formës së prerë për kryerjen e veprave penale;
- d) të mos ketë ndaj tij masa disiplinore që nuk janë shuar;
- e) të demonstrojë vlera të larta të etikës, sjelljes dhe komunikimit;
- f) të demonstrojë aftësi të punës në grup dhe të motivimit

Aplikanti duhet të plotësojë kriteret e posaçme si vijon:

- a) njohuri dhe përvojë të mjaftueshme në praktikat e këshillimit dhe orientimit, mundësisht për të rritur;
- b) njohuri për politikat publike dhe orientimet kryesore strategjike në fushën e arsimit dhe formimit për të rriturit/të nxënit gjatë gjithë jetës;
- c) nivel të kënaqshëm njohurish për kuadrin ligjor të njohjes, si dhe për të drejtat dhe detyrat e kandidatëve, plus trajnimin fillestar;
- ç) diplomë "Bachelor" – niveli 6 i KSHK-së në shkencat shoqërore, ose në fushën e menaxhimit të burimeve njerëzore ose fusha të ngjashme

2.Dokumentet e aplikimit

Dosja e aplikimit, e cila përmban dokumentacionin e kërkuar, sipas njoftimit të vendit të lirë, duhet të përfshijë:

- letërmotivimin për pozicionin;
- jetëshkrimin (CV-në);
- kartën e identitetit;
- diplomën;
- librezën e punës;
- çdo dokumentacion tjetër që vërteton kualifikimet, trajnimet apo të tjera të përmendura në CV;
- certifikatën ose dëshminë për nivelin e njohurive në teknologjinë e informacionit;
- vërtetimin e gjendjes shëndetësore;
- vërtetimin e gjendjes gjyqësore;
- vërtetimin nga punëdhënësit i fundit, që ndaj tij nuk ka marrë masa disiplinore në fuqi
- të paktën një rekomandim ose vlerësim pune nga punëdhënësi të mëparshëm.

Të gjitha dokumentet duhet të jenë origjinale ose të noterizuara;

Dokumentet në gjuhë të huaj duhet të jenë të përkthyer dhe të noterizuara.

Dokumentet e aplikimit dorëzohen në protokollin e ofruesit të AFP-së, brenda datës 01.10.2026.

3. Vlerësimi i kandidatëve do bëhet referuar përcaktimeve të udhëzimit nr. 759, datë 30.9.2024, “Për mënyrën e organizimit dhe veprimtarisë, menaxhimit e burimeve njerëzore, përbërjen e njësisë së zhvillimit të institucioneve, ofruesve të arsimit dhe formimit profesional dhe zhvillimit të vazhduar profesional të personelit”, i ndryshuar.

DREJTOR
LEONIDHA HAXHINIKOLLA

